



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME E NDËRTIMIT "KARL GEGA" TIRANË

Nr. 78 Prot.

Tiranë, më 03.04 2024

Lënda :Njoftim për shpallje vendi vakant për specialist finance

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore

DREJTORISË E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit Nr.15 datë 16.02.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", VKM nr 554 date 31.07.2019 " Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punesimit dhe Aftësive (AKPA) "Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Nr.14, datë 27.05.2021 "PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT", neni 122 pikë 5 dhe neni 116 ju njoftojmë për:

1. Specialist finance - 1(një)

Kandidati aplikues për personel mbështetës në ofruesit e AFP-së duhet të përmbushë kriteret si më poshtë, si edhe kriteret e përgjithshme e të posaçme të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret e posaçme për specialist finance (nëse ka)

- a) të ketë të paktën diplomë të nivelit *Bachelor*, në shkenca ekonomike , sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

3. Dokumentet e aplikimit Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;

c) kartën e identitetit;

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda afateve të aplikimit të përcaktuara në shpallje 19 /04/2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Konceptoi: E. Kumbara

Pranoi: I. Gorçe

Miratoi: I. Gorçe

Konfirmoi: I. Gorçe



DREJTOR

Ing. Indrit Gorçe